

**PROJEKTI: “LUMI SHUSHICA: HEC DRASHOVICA, HEC KOTA, HEC
GJORMI, HEC BRATAJ“**

VENDNDODHJA: QARKU VLORE.

INVESTITOR: SHUSHICA HYDROPOWER

Përmbledhje e lëndës:

1. Përshkrimi gjeografik i zonës
2. Të dhëna mbi projektin
3. Hapësira e vëzhguar
4. Metodologjia e ndjekur për vëzhgimin arkeologjik sipërfaqësor
5. Rezultati i vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor
6. Paraqitje e përmbledhur e potencialit arkeologjik të zonës
7. Rekomandime
8. Bibliografi

1. PËRSHKRIMI GJEOGRAFIK I ZONËS

Zona ku do të zhvillohet projekti gjendet tërësisht në lumin e Shushicës dhe brigjet e tij (**Fig. 1**). Ky lum është dega kryesore e lumit të Vjosës. Ai rrjedh në jugperëndim të qytetit të Vlorës dhe ka gjatësi totale prej 81.6 km dhe gjerësi nga disa qindra metra në 2-3 km. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës është 715 km², ka lartësi mesatare prej 540 m dhe rënie 14 m/km.




Fig. 1. Vendndodhja e projektit te propozuar

Lugina e Shushicës (**Fig. 2**) shtrihet ndërmjet malësisë së Kurveleshit në lindje dhe vargut Çikë-Lungarë në perëndim. Ky lum ka burimet në ndërmjet Malit të Thatë dhe Gjoshnikoshit, në lindje të fshatit Kuç. Si burime kryesore për furnizimin e tij janë Buronjat e Kuçit. Kjo është pika më skajore e luginës në lindje. Deri në afërsi të këtij fshati mban emrin Zhuri i Kuçit, ka shtrat me zhavorr dhe rrallë ka rrjedhje sipërfaqësore. Përtej fshatit Kuç, pasi bashkohet me ujërat e disa burimeve dhe derdhet në Përroin e Thatë, mer emrin Lumi Shushicës. Pika më skjore e lumit gjendet në perëndim, pranë Selenicës, Rrjedha e Shushicës ndjek ultësirën ndërmjet vargjeve malore Kurvelesh-Gribë dhe Çikë-Lungarë. Degët kryesore të këtij lumi gjenden në krahun e djathtë të rrjedhës. Ato janë përrrenjtë e: Smokthinës, Vajzës, Vllahinës. Deri në afërsi të fshatit Brataj, Shushica ka shtrat të ngushtë dhe të thellë. Nga këtu e deri në

Drashovicë, lumi rrjedh në një shtrat të gjerë, deri 80-120 m dhe me brigje të larta. Poshtë Drashovicës, deri në derdhjen e tij në Vjosë, pranë fshatit Beshisht, rrjedh në një shtrat të gjerë deri në 250 m. Shushica derdhet në rrjedhën e lumit Vjosë, duke shërbyer edhe si një nga degët kryesore të Vjosës.

Ajo komunikon me bregdetin e Jonit nëpërmjet qafës së Dërrasës dhe luginës së Kudhësit, me fushën e Dukatit dhe Orikumin me anë të qafës së Shën Gjergjit, me Kurveleshin e sipërm dhe zonën e Tepelenës me anë të përroit të Zhurit, ndërsa me gjirin e Vlorës nëpërmjet qafës së Koçiut. Lugina ndërtohet kryesisht nga flishe argjilo-ranor të oligocenit, molasa dhe më pak nga depozitime kuaternare, të cilat dalin kryesisht në degën e poshtme¹.



Fig. 2. Pamje e luginës së Shushicës, nga Kodra e Mavrovës.

Në pjesën më të madhe të tij, terreni i kësaj lugine, e cila shkon nga 200 - 1860 m lartësi mbi nivelin e detit, është shkëmbor dhe me shumë luhatje. Shtrati i lumit ka kthesa të shumta, gjarpërime e meander. Meandre me përmasa të mëdha e të shprehura qartë vërehen në sektorët nga Brataj në Drashovicë². Ana e djathtë e luginës ndërpritet në dy pika nga rrjedha e lumit të Smokthinës dhe përroit të Vajzës. Kjo anë me reliev kodrinor ndërtohet nga depozitime flishore, ndërsa ana e majtë ndërtohet kryesisht nga gëlqeror³. Në formimin e klimës së luginës së Shushicë ndikojnë pozita e saj pranë detit, malet e larta që e rrethojnë në pjesën e sipërme dhe të mesme e sidomos hapja në drejtim të veri-perëndimit⁴. Sasia vjetore e reshjeve që bie përgjatë luginës varion nga 1113 mm reshje në 2405 mm reshje. Temperatura mesatare është 14 °C. Temperaturat në janar arrin mesatarisht 5.7 °C, ndërsa në gusht 23.3 °C⁵. Për shkak të klimës bimësia kryesore që rritet përgjatë luginës është makja mesdhetare me gjelbërim të përhershëm, ku vendin kryesor e zë përalli, mareja, xina dhe mretja.

¹ KRUTJA 1991, f. 343.

² KRUTJA 1991, f. 343.

³ KRUTJA 1991, f. 344.

⁴ KRUTJA 1991, f. 344.

⁵ KRUTJA 1991, f. 344.

2. TË DHËNA MBI PROJEKTIN

Ky projekt parashikon ndërtimin e katër hidrocentraleve mbi shtratin e lumit Shushicë (Fig. 3). Në vazhdim po paraqesim detajet teknike të secilit prej tyre⁶.



Fig. 3. Planvendosja e HEC-eve

HEC Drashovica (Fig. 4)

Vepra e Marrjes do të ndërtohet në një zonë relativisht të gjerë, me gjerësi 140-150 m të shtratis dhe është e tipit me marrje anësore, me nivel normal të ujit mbi pragun kapërderdhës anësor të marrjes të ujit 77.50m m.n.d. Aksi i zgjedhur karakterizohet nga një grykë relativisht e gjerë, e cila ka të njëjtat tipare në drejtim të rrjedhjes, deri në urën e fshatit Drashovicë, më pas lumi zgjerohet dhe më shumë duke mbajtur një gjerësi të ndryshueshme 150-250m deri në derdhjen në lumin Vjosë.

Pozicioni i dekantuesit është përcaktuar të vendoset direkt mbas veprës së marrjes dhe lidhet me të me anë të pjesës rakorduese prej betoni, me seksion drejtkëndor, i vendosur në taracën e majtë të lumit të Shushicës, në një zonë të rafshët. Dekantuesi ndërtohet për shkak të përmbajtjes së aluvioneve, sidomos të atyre me diametër relativisht të vogël (që arrijnë të kalojnë zgarën e veprës anësore të marrjes të ujit).

Kanali i Derivacionit fillon direkt mbas daljes nga dekantuesi dhe është parashikuar të jetë një kanal betoni me seksion trapezoidal, me gjatësi rreth $L=600\text{m}$, pjerrësi $i=0.001$, gjerësi të bazës të poshtme të kanalit $b=4\text{m}$, pjerrësia e skarpave 1H-1V, thellësi të ujit në kanal $H_u=1.65\text{m}$, dhe gjerësi të nivelit të sipërm të sipërfaqes së ujit $B_u=7.30\text{m}$, me një rezervë mbi nivelin e ujit prej 0.50m. Trashësia e mureve të skarpatës të kanalit është pranuar 10cm, ndërsa trashësia e dyshemesë 15cm. Mbas përfundimit të kanalit të derivacionit, uji hyn në basenin e presionit me kuotë të dyshemesë të kanalit, në hyrje të basenit 73.08m m.n.d.

Bazuar sa më sipër dhe sipas të dhënave topografike të trasesë së kanalit të derivacionit, është ndërtuar modeli hidraulik ku janë kryer simulimet hidraulike për parametra të ndryshëm gjeometrik të seksionit, të dhënë në vijim të këtij raporti.

Baseni i presionit do të ndërtohet direkt mbas kanalit të derivacionit dhe lidhet me të me anë të pjesës rakorduese. Niveli normal i ujit në basenin e presionit është në kuotën 74.73m m.n.d. Baseni do të jetë beton arme, i pajisur me zgarë për mos futjen e papastërtive në tubacionin e turbinave, një portë në hyrje të tubacioneve të turbinave për manovrimin në raste avarish, kapërderdhës anësor për shkarkimin

⁶ Ky materil është përgatitur nga GR Albania.

e prurjes llogaritëse në rast avarish dhe një tubacion fundor Ø1600mm për pastrimin dhe shkarkimin e basenit të presionit në krahun e djathtë të tij. Tubacioni shkarkimit do të trasohet deri në lumë për të mos dëmtuar shpatin e luginës dhe ka një gjatësi rreth 150m.

Tubacioni i turbinave do të ndërtohet në vazhdimësi të basenit të presionit dhe trasohet në taracën e majtë të luginës të lumit Shushica me diametër të jashtëm Ø=3020mm dhe gjatësi L=500m dhe përfundon në ndërtesën e centralit të HEC-Drashovica në kuotën 56m m.n.d, i cili është niveli i shkarkimit të ujit të turbinave *Francis*. Tubacioni gjatë trasesë do të pajiset me ankera B/A në këndet që ai formon në planin vertikal dhe horizontal.

Ndërtesa e Centralit, e HEC-Drashovica vendoset në një taracë në anën e majtë të lumit Shushica, me kuotë +0.00m (57.5m m.n.d), rreth 1.5m sipër nivelit të ujit në kanalin e shkarkimit. Kuota e shkarkimit të HEC-Drashovica është pranuar 56.0m m.n.d. Kjo kuotë arrihet duke gërmuar shtratin e lumit me një gjatësi në rreth 250m për të rakorduar kanalin e shkarkimit me rrjedhën e lumit. Në godinën e HEC-Drashovica janë parashikuar të instalohen tre turbina *Francis* me fuqi totale të vendosur 3330 kW, ku dy turbina janë me fuqi 1320kW secila dhe turbina tjetër me fuqi 660kW).




Fig. 4. Hec Drashovica




Fig. 5. HEC Kota

HEC Kota (Fig. 5)

Vepra e marrjes do të ndërtohet në një zonë relativisht të gjerë, me gjerësi 70-85 m të shtratit dhe është e tipit me marrje anësore, me nivel normal të ujit mbi zgarën ujëmarëse 101.40m m.n.d. Aksi i zgjedhur karakterizohet nga një gryke relativisht e gjerë e cila ka të njëjtat tipare në drejtim të rrjedhjes deri në fillim të fshatit Kotë, më pas lumi zgjerohet dhe më shumë duke mbajtur një gjerësi të ndryshueshme 100-120m deri në fshatin Drashovicë dhe 150-250m deri në derdhjen në lumin Vjosë.

Në krahun a djathtë të rrjedhjes në taracën lumore, direkt mbas vepres së marrjes do të ndërtohet dekantuesi.

Pozicioni i dekantuesit është përcaktuar të vendoset direkt mbas vepres së marrjes dhe lidhet me të me anë të pjesës rakorduese prej betoni me seksion drejtkëndor i vendosur në taracën e djathtë të lumit

të Shushicës në një zonë të rafshët. Dekantuesi ndërtohet për shkak të përmbajtjes së aluvioneve, sidomos te atyre me diametër relativisht të vogël (që arrijnë të kalojnë zgarën e veprës marrjes të ujit).

Kanali i Derivacionit, fillon direkt mbas daljes nga dekantuesi dhe është parashikuar të jetë një kanal betoni me seksion trapezoidal, me gjatësi rreth $L=1685.00$ m, përfshirë dhe gjatësitë e tre urë kanaleve, me gjatësi 37.55m urë kanali i parë, 49.55m urë kanali i dytë dhe 68.52m urë kanali i tretë. Pjerrësia e kanalit është $i=0.001$, gjerësi të bazës të poshtme të kanalit $b=4.00$ m, pjerrësia e skarpave 1H-1V, thellësi të ujit në kanal $H_u=1.60$ m, dhe gjerrësi të nivelit të sipërm të sipërfaqes së ujit $B_u=7.20$ m, me një rezervë mbi nivelin e ujit prej 0.50m. Trashësia e mureve të betonit të skarpatës të kanalit është pranuar 10cm, ndërsa trashësia e dyshemesë 12cm. Mbas përfundimit të pjesës së parë të kanalit të derivacionit uji kalon mbi urë kanalin e parë me pjerrësi $i=0.005$ dhe gjatësi 37.55m përfshirë pjesët rakorduese me kanalin trapezoidal, më pas vazhdon përsëri me kanal trapezoidal dhe më pas kalon në urë kanalin e dytë me pjerrësi $i=0.005$ dhe gjatësi 49.55m, dhe më pas vazhdon përsëri me kanal trapezoidal dhe më pas kalon në urë kanalin e tretë me pjerrësi $i=0.005$ dhe gjatësi 68.52m. Mbas përfundimit të kanalit të derivacionit uji hyn në basenin e presionit me kuotë të dyshemesë të kanalit në hyrje të basenit 97.58m m.n.d dhe kuotë të nivelit normal të ujit në basen presioni 99.19m m.n.d.

Seksioni tërthor i lagur i urë kanaleve ($B_u * H_u$) është $(3.0*1.60)$ m dhe ka një franko rezervë nga niveli i ujit prej 0.5m, trashësia e mureve dhe bazamentit të urëkanalit është 20cm, vizatimet me armimet e detajuara të urëkanalit jepen në vizatimet përkatëse të projekt zbatimit.

Baseni i presionit do të ndërtohet direkt mbas kanalit të derivacionit dhe lidhet me të me anë të pjesës rakorduese. Niveli normal i ujit në basenin e presionit është në kuotën 99.19m m.n.d. Baseni do të jetë beton arme, i pajisur me zgarë për mos futjen e papastërtive në tubacionin e turbinave, një portë në hyrje të tubacioneve të turbinave për manovrimin në rast avarish, kapërderdhës anësor për shkarkimin e prurjes llogaritëse në rast avarish, një portë anësore për shkarkimin e basenit dhe një tubacion fundor Ø1600mm për pastrimin dhe shkarkimin e basenit të presionit në krahun e majtë të tij. Tubacioni shkarkimit do të trasohet deri në lumë për të mos dëmtuar shpatin e luginës dhe ka një gjatësi rreth 30m.

Tubacioni i turbinave do të ndërtohet në vazhdimësi të basenit të presionit dhe trasohet në taracën e djathtë të luginës të lumit Shushica me diametër të jashtëm të tubit Ø=3020mm dhe gjatësia totale e tubacionit të turbinave është rreth $L=550$ m dhe perfundon në ndertesën e centralit të HEC-KOTA në kuotën 83.00m m.n.d i cili është niveli i shkarkimit të ujit të turbinave *Francis*. Tubacioni gjatë trasesë do të pajiset me ankerë B/A në këndet që ai formon në planin vertikal dhe horizontal.

Ndërtesa e Centralit, e HEC-Kota vendoset në një taracë në anën e djathtë të lumit Shushica, me kuotë $+0.00$ m (84.5m m.n.d), rreth 1.5m sipër nivelit të ujit në kanalin e shkarkimit. Kuota e shkarkimit të HEC-Kota është pranuar 81.00m m.n.d, kjo kuotë arihet duke gërmuar shtratin e lumit me gjatësinë rreth 50-60m për të rakorduar kanalin e shkarkimit me nivelin e ujit në lumë. Në godinën e HEC-Kota janë parashikuar të instalohen tre turbina *Francis* me fuqi totale të vendosur 2650 kW, ku dy turbina janë me fuqi 1060kW dhe prurje 8m³/s secila, dhe turbina tjetër me fuqi 530 kW dhe prurje 4m³/s.

HEC Gjormi (Fig. 6)

Vepra e marrjes do të ndërtohet në një zonë relativisht të gjerë, me gjerësi 80-120 m të shtratit dhe është e tipit me marrje anësore, me nivel normal të ujit mbi zgarën ujëmarëse 126.00m m.n.d. Aksi i zgjedhur karakterizohet nga një grykë relativisht e gjerë e cila ka të njëjtat tipare në drejtim të rrjedhjes deri në urën e fshatit Drashovicë, më pas lumi zgjerohet dhe më shumë duke mbajtur një gjerësi të ndryshueshme 150-250m deri në derdhjen në lumin Vjosë. Në krahun e majtë të rrjedhjes, në taracën lumore direkt mbas vepres së marrjes do të ndërtohet dekantuesi.

Pozicioni i dekantuesit është përcaktuar të vendoset direkt mbas vepres së marrjes dhe lidhet me të me anë të pjesës rakorduese prej betoni me seksion drejtkëndor i vendosur në tracën e djathtë të lumit

të Shushicës, në një zonë të rafshët. Dekantuesi ndërtohet për shkak të përmbajtjes së aluvioneve, sidomos të atyre me diametër relativisht të vogël (që arrijnë të kalojnë zgarën e veprës marrjes të ujit).

Kanali i Derivacionit, fillon direkt mbas daljes nga dekantuesi dhe është parashikuar të jetë një kanal betoni me seksion trapezoidal, me gjatësi rreth $L=1845.00$ m përfshirë dhe gjatësinë e urë kanalit me gjatësi 91.60 m përfshirë dhe pjesët rakorduese në hyrje dhe në dalje, pjerrësia e kanalit është $i=0.001$, gjerësi të bazës të poshtme të kanalit $b=3.50$ m, pjerrësia e skarpatave $1H-1V$, thellësi të ujit në kanal $H_u=1.60$ m, dhe gjerësi të nivelit të sipërm të sipërfaqes së ujit $B_u=6.70$ m, me një rezervë mbi nivelin e ujit prej 0.50 m. Trashësia e mureve të skarpatës së kanalit është pranuar 12 cm, dhe trashësia e dyshemesë 12 cm. Mbas përfundimit të pjesës së parë të kanalit të derivacionit uji kalon edhe mbi një urë kanal me pjerrësi $i=0.005$, gjatësi 91.6 m përfshirë pjesët rakorduese me kanalin trapezoidal, dhe më pas vazhdon përsëri me kanal trapezoidal dhe më pas hyn në basenin e presionit me kuotë të dyshemesë të kanalit në hyrje të basenit 122.12 m m.n.d dhe kuotë të nivelit normal të ujit në basen presioni 123.72 m m.n.d.

Seksioni tërthor i lagur i urë kanalit ($B_u \times H_u$) është (3.0×1.50) m dhe ka një franko rezervë nga niveli i ujit prej 0.5 m, trashësia e mureve dhe bazamentit të urëkanalit është 20 cm.

Baseni i presionit do të ndërtohet direkt mbas kanalit të derivacionit dhe lidhet me të me anë të pjesës rakorduese. Niveli normal i ujit në basenin e presionit është në kuotën 123.72 m m.n.d. Baseni do të jetë beton arme, i pajisur me zgarë për mos futjen e papastërtive në tubacionin e turbinave, një portë në hyrje të tubacioneve të turbinave për manovrimin në raste avarish, kapërderdhës anësor për shkarkimin e prurjes llogaritëse në rast avarish, një portë anësore për shkarkimin e basenit dhe një tubacion fundor $\varnothing 1600$ mm për pastrimin dhe shkarkimin e basenit të presionit në krahun e majtë të tij. Tubacioni shkarkimit do të trasohet deri në lumë për të mos demtuar shpatin e luginës dhe ka një gjatësi rreth 50 m.

Tubacioni i turbinave do të ndërtohet në vazhdimësi të basenit të presionit dhe trasohet në taracën e djathtë të luginës të lumit Shushica me diametër të jashtëm të tubit $\varnothing=3020$ mm dhe gjatësia totale e tubacionit të turbinave është rreth $L=70$ m dhe perfundon në ndërtesën e centralit të HEC-GJORM në kuotën 101.40 m m.n.d i cili është niveli i shkarkimit të ujit të turbinave *Kapllan*.

Tubacioni gjatë trasesë do të pajiset me ankera B/A në këndet që ai formon në planin vertikal dhe horizontal.

Ndërtesa e Centralit e HEC-Gjormi vendoset në një taracë në anën e djathtë të lumit Shushica, me kuotë $+0.00$ m (105.5 m m.n.d), rreth 1.5 m sipër nivelit të ujit në kanalin e shkarkimit. Kuota e shkarkimit të HEC-Gjormi është pranuar 101.40 m m.n.d, kjo kuotë arihet duke gërmuar shtratin e lumit me një gjatësinë rreth 50 m për të rakorduar kanalin e shkarkimit me nivelin e ujit në lumë. Në godinën e HEC-GJORMI janë parashikuar të instalohen tre turbina *Francis* me fuqi totale të vendosur 3100 kW, ku dy turbina janë me fuqi 1240 kW dhe prurje 7.44 m³/s secila, dhe turbina tjetër me fuqi 620 kW dhe prurje 3.72 m³/s.

HEC Brataj (Fig. 7)

Vepra e marrjes do të ndërtohet në një zonë relativisht të gjerë, me gjerësi $65-80$ m të shtratit dhe është e tipit me marrje anësore, me nivel normal të ujit mbi zgarën ujëmarëse 179.80 m m.n.d. Aksi i zgjedhur karakterizohet nga një grykë relativisht e gjerë e cila ka të njëjtat tipare në drejtim të rrjedhjes deri në HEC-in ekzistues të Smokthinës, më pas lumi zgjerohet dhe më shumë $80-150$ m deri në urën e fshatit Drashovicë, dhe poshtë urës së Drashovicës zgjerohet përsëri duke mbajtur një gjerësi të ndryshueshme $150-250$ m deri në derdhjen në lumin Vjosë. Në krahun e djathtë të rrjedhjes në taracën lumore direkt mbas vepres së marrjes do të ndërtohet dekantuesi.

Pozicioni i dekantuesit është përcaktuar të vendoset direkt mbas vepres së marrjes dhe lidhet me të me anë të pjesës rakorduese prej betoni me seksion drejtkëndor i vendosur në taracën e djathtë të lumit të Shushicës, në një zonë jo shumë të rafshët, në kufi të skarpatës dhe do të krijohet me anë të gërmimeve.

Dekantuesi ndërtohet për shkak të përmbajtjes së aluvioneve, sidomos të atyre me diametër relativisht të vogël (që arrijnë të kalojnë zgarën e veprës marrjes të ujit).

Kanali i Derivacionit, fillon direkt mbas daljes nga dekantuesi dhe është parashikuar të jetë një kanal betoni me seksion trapezoidal, me gjatësi rreth $L=7462.10$ m, pjerrësia e kanalit është $i=0.001$, gjerësi të bazës të poshtme të kanalit $b=3.00$ m, pjerrësia e skarpave 1H-1V, thellësi të ujit në kanal $H_u=1.53$ m, dhe gjerësi të nivelit të sipërm të sipërfaqes së ujit $B_u=6.06$ m, me një rezervë mbi nivelin e ujit prej 0.47m. Trashësia e mureve të skarpatës të kanalit është pranuar 12cm, dhe trashësia e dyshemesë 12cm. Kanali gjatë trasesë intersekon disa përoska, kalimi i të cilave bëhet me anë tombinove dhe kanali kalon sipër tyre, më pas hyn në basenin e presionit me kuotë të dyshemesë të kanalit në hyrje të basenit 170.84m m.n.d dhe kuotë të nivelit normal të ujit në basen presioni 172.37m m.n.d.




Fig. 6. HEC Gjormi




Fig.7. HEC Brataj

Baseni i presionit do të ndërtohet direkt mbas kanalit të derivacionit dhe lidhet me të me anë të pjesës rakorduese. Niveli normal i ujit në basenin e presionit është në kuotën 172.372m m.n.d. Baseni do të jetë beton arme, i pajisur me zgarë për mos futjen e papastërtive në tubacionin e turbinave, tre porta në hyrje të tubacioneve të turbinave për manovrimin në raste avarish, kapërderdhës anësor për shkarkimin e prurjes llogaritëse në rast avarish, një portë anësore për shkarkimin e basenit dhe një tubacion fundor Ø1600mm për pastrimin dhe shkarkimin e basenit të presionit në krahun e majtë të tij. Tubacioni shkarkimit do të trasohet deri në lumë për të mos dëmtuar shpatin e luginës dhe ka një gjatësi rreth 150m.

Tubacioni i turbinave do të ndërtohet në vazhdimësi të basenit të presionit dhe trasohet në taracën e djathtë të luginës të lumit Shushica. Për Hec Brataj është vendosur të pranohen tre tubacione turbinash duke qënë se distanca nga baseni i presionit për në godinën e HEC-it është e shkurtër, dhe është vlerësuar nga pikpamja tekniko-ekonomike si më e leverdishmja. Tubacionet e turbinave konsistojnë në: dy tubacione me diametër të jashtëm të tubit Ø=1820mm tubacioni i tretë me diametër të jashtëm të tubit Ø=1520mm. Gjatësia totale e tubacionit të turbinave është rreth $L=148.50$ m secili tubacion, dhe mbas daljes nga baseni i presionit perfundojnë në ndërtesën e centralit të HEC-Brataj në kuotën 126.00m m.n.d

e cila është niveli i shkarkimit të ujit të turbinave *Francis*. Tubacionet gjatë trasesë do të pajisen me ankera B/A në këndet që ai formon në planin vertikal dhe horizontal.

Ndërtesa e Centralit, e HEC-Brataj vendoset në një taracë në anën e djathtë të lumit Shushica, me kuotë $+0.00\text{m}$ (127.5m m.n.d), rreth 1.5m sipër nivelit të ujit në kanal in e shkarkimit. Kuota e shkarkimit të HEC-Brataj është pranuar 126.00m m.n.d, kjo kuotë arihet duke gërmuar shtratin e lumit me një gjatësi rreth 30-40m për të rakorduar kanal in e shkarkimit me nivelin e ujit në lumë. Në godinën e HEC-Brataj janë parashikuar të instalohen tre turbina *Francis* me fuqi totale të vendosur 5850 kW, ku dy turbina janë me fuqi 2340kW dhe prurje 6.04m³/s secila, dhe turbina tjetër me fuqi 1170 kW dhe prurje 3.02m³/s.

3. HAPËSIRA E VËZHGUAR

Hapësira e vëzhguar përbëhet nga e gjithë zona e parashikur nga kompania zhvilluese për të vendosur veprat e ndryshme ndërtimore (**Fig. 8**), me gjatësi 23 km linear. Kujdes i veçantë ju kushtua territoreve që ndodhen pranë zonave të njohura me potencial arkeologjik (**Fig. 9**).




Fig. 8. Vendosja e HEC-eve




Fig. 9. Monumentet në zonë

Për të pasur një pamje sa më të qartë të situatës u vizituan edhe monumentet e njohura arkeologjike dhe historike në zonë. Territori i kontrolluar në të gjithë hapësirën e mësipërme zinte një sipërfaqe prej mbi 29,7 km².

Nga verifikimi në terren dhe përgjatë vëzhgimit sipërfaqësor në të gjithë territorin ky synohet të shtrihet projekti, konstatohet qartësisht se nuk ka asnjë punim nga ana e kompanisë aplikuese për zhvillim. Për zhvillimin e projektit do të përdoret rruga ekzistuese, e cila është e gjitha e shtruar me asfalt deri pranë fshatit Brataj. Vetëm pjesa më ekstreme e projektit përshkohet nga një rrugë fshati e pashtuar. Për rrjedhojë, nuk është parashikuar hapja e rrugëve të reja. Në pjesën tjetër të terrenit do të përdoret shtrimi i kanalit si rrugë vendosjeje e linjave.

4. METODOLOGJIA E NDJEKUR PËR VËZHGIMIN ARKEOLOGJIK SIPËRFAQËSOR

Realizimi i vëzhgimit sipërfaqësor, metodologjia dhe hartimi i raportit u realizua në përputhje me “Rregulloren e profesionit të arkeologut, kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike”, miratuar me Vendim nr. 2, datë 30.01.2009, të KKA-së. Terreni u përshkua në këmbë e gjithë gjatësia e parashikuar për realizimin e hidrocentraleve dhe të elementëve përbërës të tyre nga ekipi i përzgjedhur nga subjekti i licencuar. U realizua një ecje në vijë të drejtë për traktet ku një lëvizje e tillë ishte e mundur. Sipas gjendjes së terrenit, u krye një ecje paralele me dy ose tre vëzhgues. Distancat mes vëzhguesve varionin sipas llojit të terrenit të vetë trakteve, nga 2 m deri në 10 m larg njëri-tjetrit (**Fig. 10-13**). Për dokumentimin sa më të saktë të zonës, gjatësia e veprës së parashikuar u nda në disa trakte dhe u plotësuan kartela individuale. Traktet u emërtuan me numra arabë në rend rritës dhe u trajtuan sipas tipologjisë së veprave ndërtimore të parashikuara. Për veprat e digave, u realizua një vëzhgim gjerësor në raport me shtratin e lumit. Për hapësirat e parashikuara për ndërtesat e Veprave të Marrjes, HEC dhe Baseneve të Presionit, u vëzhgua sipërfaqja e destinuar për ndërtim. Për pellgjet ujëmbledhëse, të cilat shtrihen në shtratin e lumit u verifikua nëse kishte gjetje në të, gjithmonë sipas mundësisë së penetrimit në territor. Për linjat e shtrirjes së kanaleve apo tubave u realizua një vëzhgim gjatësor linear duke ndjekur aksin e propozuar, në pothuaj të gjithë linjat e parashikuara.



Fig. 10. Momente pune



Fig. 11. Momente nga vëzhgimi



Fig. 12. Momente nga vëzhgimi



Fig. 13. Momente nga vëzhgimi

Përgjatë ecjes u vëzhgua me kujdes pozicioni i trakteve në raport me monumentet e njohura dhe në raport me potencialin e mundshëm arkeologjik të terrenit. U realizuan vëzhgime të detajuara për të parë pozicionimin e tyre, në raport me trashëgiminë arkeologjike dhe historike, u morën shënimet përkatëse, u realizuan fotografitë që dëshmojnë të tillë aktivitete dhe u procedua në përgatitjen e raportit përkatës me të gjitha detajet e nevojshme. Për realizimin e një pune të tillë janë përdorur mjetet standarte logjistike të realizimit të vëzhgimit arkeologjik: hartë topografike në shkallë 1:25.000, ortofoto të zonës, klikera mekanikë, metër shirit, skedat përkatëse, aparta fotografik digjital, latë 3 m.

Ekipi përbëhej nga:

Eduard Shehi, arkeolog. Vëzhgues, përgatiti raportin arkeologjik.

Klodian Velo, arkeolog. Vëzhgues, mbajtës i skedave të trakteve.

Erald Hasanaj, inxhinier. Vëzhgues, Hartograf.

5. REZULTATI I VËZHGIMIT ARKEOLOGJIK SIPËRFAQËSOR

Organizimi i punës dhe identifikimi i trakteve u bazua në projektin e përgatitur nga ana e GR Albania dhe është i lidhur ngushtësisht me këtë projekt.

Traktet e përshkruara përgjatë vëzhgimit sipërfaqësor u pozicionuan me GPS në të gjithë gjatësinë e parashikuar për ngritjen e HEC-ve. I gjithë territori u nda në 12 trakte (**Fig. 14**). Këto trakta ndahen në disa kategori. Të gjitha traktet e lidhura me pellgjet ujëmbledhës janë pjesë e shtratit të lumit dhe të gjitha kanë përmbajtje zallore ose mbetje të tjera të sjellura nga lumi. Nuk u konstatua asnjë gjurmë e lidhur me trashëgiminë arkeologjike. Të katërt pellgjet ujëmbledhëse, sipas projektit të paraqitur, nuk prekin hapësirat ku gjenden urat e shpallura monumente kulture.




Fig.14. Ndarja ne trakte




Fig. 15. Traktet 1-3

Traktet e lidhura me ndërtimet e ngrehinave janë të kufizuara në shtrirje dhe rezultuan pa gjetje sipërfaqësore. Vegjetacioni lejonte shikueshmëri të pakët të terrenit. Ato nuk kanë afërsi me hapësirat ku ndodhet monumente arkeologjike-historike të njohura nga bibliografia e botuar.

Trakti 1 (pellgu ujëmbledhës i HEC Brataj) (**Fig. 15**), shtrihet i gjithi në shtratin e lumit të Shushicës (**Fig. 18**) (1 km). Në fazën e parë të projektit është konstatuar nga ana e institucioneve të Ministrisë së Kulturës se gjendej shumë pranë Urës së Bratajt, shpallur monument kulture. Si pasojë e kësaj vërejtjeje, nga ana e projektuesit u ndryshua linja dhe u vendos në një distancë të pranueshme sigurie (**Fig. 16**). Megjithatë, mbetemi të paqartë mbi ndikimin e saj në peisazhin e monumentit të kulturës. Nuk jemi të qartë nëse nga qëndrimi mbi Urën e Bratajt shikohet një pjesë e digës.




Fig. 16. Ripozicionimi i traktit pranë urës Brataj




Fig. 17. Monumentet prane trakteve 1-30



Fig. 18. Pamje e shtratit ku shtrihet trakti 1

Trakti nr. 2 (kanali i derivacionit të HEC Brataj) (**Fig. 17**), i cili ishte edhe më i gjati (7462 m), paraqet disa gjetje që është e nevojshme të trajtohen. Në pjesën jugore të tij, ai kalon afro 50 në perëndim të një zone me prani muresh të ruajtur në lartësi të ulët, me lidhje të thatë (**Fig. 19-20**). Terreni ishte i mbuluar në pjesën më të madhe me shkurre që vështirësonin vëzhgimin. U gjetën shumë pak fragmente qeramike, prej të cilave një vegjë paraqet forma të ngjashme me katruset e shek. XVI-XVIII (**Fig. 21**).



Fig. 19. Mbetje muresh



Fig. 20. Mbetje muresh



Fig. 21. Fragment vegje

Sipas banorëve të fshatit Brataj kjo zonë njihet me emrin Ledhet. Botimi i mëparshëm i kësaj zone është konsideruar se i takon një fshati mesjetar. Ne konstatuam në terren se linjat e mureve janë të çrregullt dhe pa forma të qarta. Ato nuk mund të jenë banesa, pasi kanë sipërfaqe të mëdha për një funksion të tillë, si dhe shtrirje jo të njëtrajtshme. Brenda sipërfaqeve që ato rrethonin nuk kishte gjurmë të tjera banimi. Gjetjet qeramike ishin minimale dhe këto në zonën perëndimore, jashtë mureve rrethuese. Megjithatë është trajtuar si një fshat mesjetar, ne shprehim dyshimin se mund të kemi të bëjmë me struktura me përdorim të përkohshëm, me funksion të paqartë, ndoshta blegtoral. Megjithatë, duke pasur parasysh emërtimin që kanë marrë këto struktura, le ti quajmë si rrënoja të një fshati.

Në pjesën qendrore të traktit nr. 2 konstatuam se kalonte afërsisht 500 m në lindje të rrënojave të kishës dhe manastirit të Shën Gjonit (**Fig. 22-23**). Monumenti gjendet i rrënuar dhe i mbuluar nga një bimësi e dendur. Ishte pothuaj i pamundur vizitueshmëria e tij. Në aksin e parashikuar të shtrirjes së kanalit të derivacionit nuk arritëm të identifikojmë gjetje sipërfaqësore.



Fig. 22. Rrenoja te kishes Shen Gjergjit



Fig. 23. Rrenoja te kishes se Shen Gjergjit

Në pjesën veriore të traktit nr. 2 konstatuam se aksi i parashikuar për kalimin e kanalit të derivacionit përshkonte një zonë të njohur se i takon një varreze të periudhës qytetare ilire. Në këtë hapësirë janë realizuar gërmime arkeologjike të kufizuara, që kanë nxjerrë në dritë varre të ndërtuara me struktura me blloqe gurësh drejtkëndore dhe me inventare. Aktualisht ruhet i hapur një varr i tillë (**Fig. 24**). Vumë re gjurmë të gërmimeve klandestine në zonë (**Fig. 25**).



Fig. 24. Varr i germaur



Fig. 25. Germim klandestin

Pjesa tjetër e këtij trakti, për aq sa shikueshmëria e terrenit të lejonte, nuk paraqiste gjetje sipërfaqësore.

Trakti 3 (ndërtesa e HEC dhe baseni i presionit) (**Fig. 26**). Bëhet fjalë për një sipërfaqe të kufizuar, pa gjetje sipërfaqësore, për aq sa lejonte shikueshmëria e terrenit.



Fig. 26. Trakti 3 përgjatë vëzhgimit



Fig. 27. Trakti 4. Pamje e terrenit

Trakti 4 (vepra e marrjes dhe pellgu ujëmbledhës i HEC Gjorm, 3.5 km) (**Fig. 27**). Trakti përfshinte shtratin e lumit si dhe brigjet anësore të tij, me shumë shkurre dhe pemë, i pakalueshëm.

Trakti 5 (kanali i derivacionit dhe vepra e marrjes) (**Fig. 28**) shtrihej në territor i përdorur si ara dhe livadhe (1845 m). Pjesërisht ishte i kalueshëm, shikueshmëria e ulët.

Trakti 6 (HEC Gjorm dhe baseni i presionit) (**Fig. 29**) ishte terren fushor, me bimësi të ndryshme, të kultivuar ose rritje natyrale.



Fig. 28. Trakti 4



Fig. 29. Trakti 6

Trakti 7 (vepra marrjes dhe pellgu ujëmbledhës HEC Kotë) (**Fig. 30**). Shtrihej në zallin e lumit dhe ledhet anësh tij (2.9 km). Në pjesën më të madhe i pakalueshëm, pa gjetje arkeologjike, për aq sa lejonte shikueshmëria.

Trakti 8 (kanali derivacionit HEC Kotë; 1120 m) (**Fig. 31**). Terren me ara të mbjedha si dhe djerrina me bar të ulët. Pa gjetje arkeologjike, për aq sa lejonte shikueshmëria.

Trakti 9 (ndërtesa HEC Kotë dhe baseni i presionit) (**Fig. 32**). Terren me bar të ulët dhe pemë të rralla. Pa gjetje arkeologjike, për aq sa lejonte shikueshmëria.

Trakti 10 (vepra marrjes, pellgu ujëmbledhës HEC Drashovicë; 3.2 km) (**Fig. 33**). Terren me zallishte, ledhe me shtuf dhe bimësi e ndryshme. Pa gjetje arkeologjike, për aq sa lejonte shikueshmëria.

Trakti 11 (kanali derivacionit HEC Drashovicë; 2695 m) (**Fig. 34**). Terreni pjesërisht me bar dhe pjesërisht me shkurre të larta. Pa gjetje arkeologjike, për aq sa lejonte shikueshmëria.

Trakti 12 (ndërtesa HEC Drashovicë dhe baseni i presionit) (**Fig. 35**). Terren i mbuluar nga shkurre të dendura, shelgje dhe pemë të larta. Pa gjetje arkeologjike, për aq sa lejonte shikueshmëria.



Fig. 30. Trakti 7



Fig. 31. Trakti 8



Fig. 32. Trakti 9



Fig. 33. Trakti 10



Fig. 34. Trakti 11



Fig. 35. Trakti 12

6. POTENCIALI ARKEOLOGJIK

Kjo zonë, që përbën dhe objektin e vëzhgimit tonë, identifikohet si lugina e mesme e lumit Shushicë ose krahina e “Lumit të Vlorës”, njësia etnografike e Labërisë ose Kurveleshit të Poshtëm, e cila, në antikitet, bënte pjesë në kufirin jug-lindor të koinonit të Amantëve. Duke qenë një luginë lumore me klimë të përshtatshme, e gjithë zona ka ofruar kushte të mira për zhvillimin e jetesës nga periudha prehistorike e deri në ditët e sotme. Vendbanimet, sitet arkeologjike dhe monumentet që gjenden përgjatë luginës i përkasin tipologjisë dhe periudhave të ndryshme kohore. Pavarësisht se potenciali që ka kjo luginë është mjaft i lartë, nga pikëpamja arkeologjike është studiuar në mënyrë të pamjaftueshme. Fillimisht disa të dhëna paraprake për sitet arkeologjike të kësaj luginë i gjejmë tek arkeologu anglez Nicolas Hammond, i cili, në vitet 1930 vizitoi pjesën më lindore të luginës dhe u kufizua kryesisht në fshatin Kuç⁷. Po në këtë periudhë nisin edhe gërmimet e para arkeologjike. Prehistoriani italian Luigi Cardini kreu gërmime arkeologjike në Shpellat e Velçës, ku gjeti material eneolitik⁸, i cili i klasifikon shpellat ndër vendbanimet më të hershme të luginës. Edhe ekspeditat e para, pas Luftës së Dytë Botërore, të kryera nga arkeologët shqiptar, do të përqëndroheshin në periudhën e prehistorisë. Në vitet 1950-57, Frano Prendi kreu disa gërmime kontrolli në shpellat e Velçës⁹. Po në këto vite u realizuan edhe gërmimet e para arkeologjike në qytetin antik të Amantias nga Skënder Anamali, ku u zbulua stadiumi antik, tempulli helenistik i quajtur “Tempulli i Afërditës”, dhe bazilika paleokristiane¹⁰. Qendrat kryesore, pjesë e territorit të amantëve përgjatë luginës, nisën të studiohen, gërmohen e dokumentohen, duke nisur nga vitet 1970. Fillimisht do të kryheshin disa fushata të rëndësishme, dokumentimesh e studimesh të fortifikimeve, në dy qendrat më të rëndësishme përgjatë rrjedhës së lumit Shushicë, në Kalanë e Mavrovës apo qendrën antike të Olympes dhe Kalanë e Cerjes. Kontributi kryesor në këtë drejtim ngelet ai i Neritan Cekës¹¹, Burhan Dautajt¹² dhe Damjan Komatës¹³. Vëzhgimet e para të tipit survey, për njohjen e potencialit arkeologjik të kësaj luginë dhe identifikimin e vendbanimeve rurale u kryen nga Damjan Komata, gjatë studimit të territorit që lidhet me qendrën antiko mesjetare të Kaninës. Vëzhgimet e tij nisin nga zona e Drashovicës dhe përfundojnë në afërsi të fshatit Tërbaç, në territorin përreth Cerjes¹⁴. Në këtë zonë u identifikua dhe gërmua prej tij bazilika e Mesaplikut¹⁵, pjesa më interesante dhe më e konservuar e të cilës ngelet dyshemeja me mozaik, që është ekspozuar pjesërisht në Muzeun Historik Kombëtar. Me interes janë dhe gërmimet e varrezave antike të territorit të amantëve, në vendin e quajtur Kriçkë dhe në Lepenicë nga Vasil Bereti¹⁶. Me rëndësi të veçantë është zbulimi i artit shkëmbor në Shpellën e Shkruar, në fshatin Lepenicë¹⁷. Vitet e fundit nuk kanë munguar vëzhgimet sipërfaqësore dhe gërmimet e kufizuara arkeologjike. Një ekip nën drejtimin e Skënder Muçaj zbuloi dhe publikoi një numër shtesash të reja në rrjedhën e poshtme dhe të mesme të Shushicës¹⁸, ku u realizua dhe gërmimi i kishës së Asomatit pranë Velçës. Për pjesën e epërme të Luginës kërkimet janë përqëndruar kryesisht në fortifikimet e periudhës së bronzit të vonë dhe hekurit të hershëm¹⁹.

⁷ HAMMOND 1967, f. 124, 239, 293-294, 522.

⁸ Francis 2005, f. 99-160.

⁹ PRENDI 1955, f. 116.

¹⁰ ANAMALI 1972, f. 61-150.

¹¹ CEKA 1975, f. 21-61.

¹² DAUTAJ 1981, f. 57-91.

¹³ KOMATA 1977-1978, f. 363-369.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ KOMATA 1984, f. 183-198.

¹⁶ BERETI 1995, f. 199-223.

¹⁷ KORKUTI 1984, f. 5-14.

¹⁸ XHYHERI *ETJ.* 2013, f. 437-458; XHYHERI *ETJ.* 2016, f. 279-295.

¹⁹ ÇIPA, MESHINI 2016, f. 68-74.

Në zonën që preket nga ndërtimet e heceve, duke nisur nga pjesa veri-perëndimore drejt jug-lindjes gjenden një numër i konsiderueshëm sitesh arkeologjike dhe monumentesh kulture. Në zonën midis Kotës dhe Drashovicës qendra antike më e rëndësishme është ajo e Mavrovës, e cila është identifikuar tashmë si qyteti antik i Olympes²⁰.

Qyteti antik i Olympes.

Qyteti antik i Olympes shtrihet mbi kodrën e Rrethunit (284 m mbi nivelin e detit), në krahë të djathtë të lumit Shushicë, ku ndodhet fshati Mavrovë i rrethit të Vlorës²¹. Prej saj kontrollohet një pjesë e luginës së mesme të Shushicës dhe degëzimi i rrugëve natyrore, që shkojnë drejt Kaonisë, apo vazhdojnë drejt Amantias. Qyteti antik shtrihej midis dy majave të kodrës dhe në shpatin perëndimor të saj, ndërsa ana lindore pritet nga një rënie e pakalueshme shkëmbore²². Në fortifikimin e qytetit dallohen dy periudha ndërtimi, në dy linja të ndryshme muresh. Rrethimi i parë qarkon vetëm pjesën jugore dhe lë të hapur pjesën e pakalueshme shkëmbore, duke krijuar një akropol. Muri është i ndërtuar me blloqe të mëdhenj gëlqerorë me forma trapezoidale me faqe të palatuara të vendosur në rreshta të shkallëzuar (Fig. 36)²³.



Fig. 36. Pamje e kullës së akropolit, nga fortifikimi i fazës së parë.



Fig. 37. Muri fortifikues i fazës së dytë.

Periudha e parë e fortifikimit në Olympe datohet në fund të shek. V p. Kr²⁴. Fortifikimi i fazës së dytë që nis në mesin e shek. IV p. Kr, përfshin dyfishin e sipërfaqes me një mur 1500 m të gjatë (Fig. 37, 38)²⁵. Gërmimet arkeologjike dëshmojnë se kodra ka qenë e banuar që në shek. VI p. Kr²⁶. Vëmendja mbi qytetin Ilir të Olympes, të përmendur nga Stefan Bizantini, është tërhequr fillimisht nga arkeologu Hasan Ceka, që botoi për herë të parë monedhat prej bronzit të këtij qyteti²⁷. Gërmimet arkeologjike të kryera në vitet 1974 dhe 1978, nën drejtimin e arkeologut Burhan Dautaj, u përqendruan në zbulimin e mureve rrethuese të qytetit, sqarimin e stratigrafisë së vendbanimit dhe kërkime të kufizuara në nekropol²⁸. Burhan Dautaj ka meritën se nëpërmjet këtyre gërmimeve dhe gjetjeve të shumta të monedhave së bashku me disa fragmente tjegullash që mbanin vulën *Olympastan*, identifikoi në rrënojat e Mavrovës qytetin antik të Olympes. Burimet epigrafike, përmasat e konsiderueshme të qytetit (rreth 19

²⁰ DAUTAJ 1981, f. 57-91.

²¹ *Po aty*.

²² CEKA 1975, f. 39; CABANES *ETJ.* 2008, f. 209.

²³ *Po aty*.

²⁴ CABANES *ETJ.* 2008, f. 210.

²⁵ DAUTAJ 1981, f. 70-71.

²⁶ DAUTAJ 1990, f. 266-267.

²⁷ CABANES *ETJ.* 2008, f. 209.

²⁸ DAUTAJ 1990, f. 266-267.

ha), si dhe të dhënat numizmatike, tregojnë se Olympe ka qenë një ndër qendrat më të rëndësishme të Ilirisë së Jugut²⁹. Ajo ka luajtur një rol të pavarur politik dhe ka patur një peshë të rëndësishme ekonomike në territorin e koinonit të Amantëve.




Fig. 38. Planimetri e qytetit antik të Olympes sipas B. Dautaj.

Nga territori i qytetit antike të Olympes ka një sërë gjetjesh arkeologjike, që shërbejnë si tregues për praninë e siteve të periudhave të ndryshme. Në fshatin Drashovicë është gjetur një stelë varri e shek. IV m. Kr, ku paraqitet figura çift e një nëne me një fëmijë³⁰. Midis Drashovicës dhe fshatit Peshkëpi, përmendet prania e një ure (Fig. 39) dhe një stacioni rrugor romak të tipit *Mansio*, ndërsa në fshatin Kropisht në vendin e quajtur “Maja e Lutros” gjenden rrënojat e një tempulli të periudhës helenistike (Fig. 40)³¹. Përballë kodrës së Mavrovës, në rrjedhën e majtë të lumit Shushicë, në vendin e quajtur Kriçkë, Vasil Bereti gërmoi disa varre të tipit cist, që i përkisnin një nekropoli helenistik të shek. VI-III p.Kr³². Nga qendra e banuar e Kotës, në jug-lindje të Mavrovës, vijnë si gjetje rasti disa stela të periudhës helenistike³³. Në fshatin Gumenic, në vendin e quajtur fusha e Murros (Fig. 41), në bregun e djathtë të lumit Shushicë, janë raportuar struktura arkitektonike dhe materiale të periudhës helenistike e antikitetit të vonë³⁴. Në afërsi të fushës së Murros, në verilindje në territorin e fshatit Velçë, gjenden rrënojat e kishës së mesjetare të Asomatit (Fig. 42) e ndërtuar me element të ripërdorur antik (Fig. 43)³⁵. Në zonën midis fshatrave Mavrovë dhe Drashovicë gjendet një nga monumentet e kulturës më të rëndësishëm të kësaj zone, Ura e Slapit.

²⁹ MANO, DAUTAJ 1984, f. 109-118.

³⁰ KOMATA 1989, f. 221; BERETI ETJ. 2011, f. 20.

³¹ XHYHERI ETJ. 2013, f. 441-453.

³² BERETI 1995, f. 212-213.

³³ BERETI ETJ. 2011, f. 18-23.

³⁴ XHYHERI ETJ. 2013, f. 452.

³⁵ XHYHERI ETJ. 2016, f. 279-288.



Fig. 39. Ura romake pranë Peshkëpisë.



Fig. 40. Tempulli në "Majën e Lutroit", Kropisht.

Ura e Slapit.

Një prej urave më të rëndësishme mesjetare përgjatë rrjedhës së këtij lumi është Ura e Slapit, që ndodhet pranë fshatit Mavrovë (Fig. 44). Ajo është urë e tipit me një hark me dopjo qemer dhe në të dy anët e harkut ruhet nga një kamare. Ura është ndërtuar në shek. XVII³⁶.




Fig. 41. Pamje nga fusha e Murros, Gumenicë.



Fig. 42. Pamje e kishës së Asomatit, Velçë.



Fig. 43. Elemente antik të ripërdorur në Kishën e Asomatit.



Fig. 44. Ura e Slapit, Drashovicë.

Pjesa tjetër e zonës që preket nga ndërtimi i heceve, duke nisur nga fshati Gjorm e Velçë e deri në fshatin Brataj, ndodhen disa nga monumentet më të rëndësishme të kësaj zone, si Ura e Bratit, Ura e

³⁶ SHTYLLA 1997, f. 134-135.

Bogdanit, Shpellat e Velçës, Kisha e Shën Gjergjit, Shpella e Shkruar e Lepenicës etj. Monumenti më i rëndësishëm dhe qendra anike e gjithë këtij territorit ka qenë Kalaj e Cerjes.



Fig. 45. Pamje e kodrës ku ndodhet fortifikimi i Cerjes.




Fig. 46. Planimetri e fortifikimit sipas N. Cekës.



Fig. 47. Pamje e murit fortifikues.



Fig. 48. Pamje e murit fortifikues.

Kalaja e Cerjes

Kalaja e Cerjes është vendosur në faqen jugore të një kodre rreth 250 m mbi nivelin e detit (Fig. 45), në bregun e djathtë të lumit Shushicë. Planimetria e fortifikimit është pothuaj drejtkëndore (Fig. 46), për t'ju përshtatur terrenit, në anën perëndimore dhe jugore në linjat më të gjata janë përdorur kthesa me kënde të drejta, ndërsa skajet veriore, verilindore dhe perëndimore, janë përforcuar me kulla kuadratike dhe rrethore. Fortifikimi duhet të ketë patur tre hyrje, një në veriperëndim, një në lindje dhe një në jugperëndim³⁷. Përgjithësisht e gjithë linja e fortifikimit ruhet në një deri dy radhë blloqesh, vetëm në pjesën verilindore dhe jugperëndimore ruhen dy fragmente muresh deri në tre blloqe lartësi (Fig. 47, 48). Teknika e ndërtimit të mureve është ajo e tipit izodomik, e ngjashme me teknikën e kalasë së Kaninës. Brenda sipërfaqes së rrethuar dallohen gjurmë banesash. Në majën e kodrës në antikitetin e vonë është ndërtuar një fortifikim me përmasa të vogla³⁸. Cerja ka shërbyer si një qendër e fortifikuar që ka luajtur një rol të rëndësishëm, për kontrollin e kufirit juglindor të koinonit të Amantëve.

Ura e Bogdanit

³⁷ CEKA 1975, f. 40-43.

³⁸ KOMATA 1978, f. 364

Për komunikimin me bregun e majtë të luginës së Shushicës, në shek. III para. Kr, poshtë kodrës së Cerjes, është ndërtuar një urë, rrënojat e të cilës ruhen ende dhe njihen me emrin Ura e Bogdanit (**Fig. 49, 50**)³⁹. Ura ka qenë e ndërtuar me mbi disa këmbë me blloqe kuadratik, me teknikën izodomike, mbi të cilën kalonte një superstrukturë druri. Ura ngrihej mbi 5 pilastra apo këmbë. Gjatësia e urës ishte rreth 30 m dhe hapi i pilastrave ishte rreth 7 m⁴⁰. Sot ruhet mirë vetëm një këmbë, e mbështetur në bregun e majtë. Ura është monument kulture i kategorisë së parë.



Fig. 49. Pamje e urës antike të Bogdanit.



Fig. 50. Pamje e vaut ku ndodhet ura antike e Bogdanit.

Përreth kalasë së Cerjes ndodhen dhe një sërë shtesh të tjera arkeologjike. Në fshatin Lepenicë, në një tarracë lumore të quajtur Zhavore, pranë hidrocentralit të Lepenicës, ndodhet një varr i tipit me konstruksion, ndoshta pjesë e një nekropoli të periudhës helenistike. Vari me blloqe antik i gërmuar nga Vasil Bereti kishte një inventar të pasur të shek. II p. Kr⁴¹. Në fshatin Mesaplik pranë kalasë së Cerjes, në pranverën e vitit 1978, në vendin e quajtur “Bregu i Kishës”, Damjan Komata zbuloi rrënojat e një bazilike paleokristiane, me përmasa 13.80 x 11 m, me tri anjata, pa narteks⁴². Tipologjikisht, Bazilika e Mesaplikut, përfaqëson një objekt të thjeshtë kulturi trenefëshe, pa narteks. Të tri anijat e kësaj bazilike ishin shtruar me mozaik polikrom. Mozaiku ishte zbukuruar me motive gjeometrike, floreale e zoomorfe. Ajo që ngjall interesin e arkeologëve dhe studiuesve të ndryshëm dhe vijon të gjenerojë debate, është kompozimi i një portreti dhe një mbishkrim pranë tij, në hapsirën e medaljonit të parë, në mozaikun e aniatës veriore. Pranë portretit, me shkronja të mëdha i vendosur në katër reshta, lexohet ΑΠΑΡΚΕΑC.

Më në veri, Kalaja e Boderit, ndodhet në anën e majtë të lumit të Smokthinës, në një kodër rreth 360 m mbi nivelin e detit, në fshatin Bashaj (**Fig. 51**). Fortifikimi me mure tipik të periudhës së antikitetit të vonë (**Fig. 52**), rrethojnë gjithë kreshtën e kodrës⁴³. Në linjën e murit në anën jugore ruhet mjaft mirë një kullë katërkëndore. Kështjella është monument kulture i kategorisë së parë. Po në këtë zone, në veriperëndim, ndodhen shpellat prehistorike të Velçës, gjithashtu monument kulture të kategorisë së parë.

³⁹ CEKA 1975, f. 42-43.

⁴⁰ SHTYLLA 1997, f. 13.

⁴¹ BERETI 1995, f. 208-210.

⁴² KOMATA 1984, f. 183-198

⁴³ KOMATA 1977-78, f. 364-365.



Fig. 51. Pamje e kodrës ku ndodhet Kalaja e Boderit.



Fig. 52. Pamje e murit fortifikues të antikitetit të vonë.

Shpellat e Velçës

Shpellat Neolitike të Velçës (neoliti i vonë), janë të vendosura në një faqe shkëmbore mbi fshatin e sotëm (**Fig. 53**), dhe janë një ndër vendbanimet e para prehistorike të zbuluara në vendin tonë. Ato u gërmuan nga Luigi Cardini në vitin 1937. Koleksioni i objekteve të dala nga gërmimi përbëhej nga materialet litike si, çekanë guri, vegla stralli, maja heshte dhe vegla prej kocke, ndërsa qeramika përbëhej kryesisht nga qeramika e zbukuruar me pikturim, si dhe ajo me incizim⁴⁴. Përballë tyre, në bregun e majtë të lumit Shushicë, ndodhet Shpella e Shkruar e Lepenicës, një ndër sitet më të rëndësishme të artit shkëmbor prehistorik, që gjendet në territorin e vendit tonë (**Fig. 54**).⁴⁵



Fig. 53. Pamje e shpellës së quajtur “Shpella Kala”, në Velçë.

Rrënojat e Kishës së Shën Gjergjit

Rrënojat e Kishës së Shën Gjergjit ndodhen në bregun e djathtë të lumit Shushicë, në fshatin Brataj (**Fig. 55**), jo shumë larg nga Kalaja e Cerejes. Kisha ruhet në gjendje rrënojë me mure që arrin deri 2-3 m lartësi në pjesën e naosit, ndërsa për narteksin kemi gjurmë fare të pakta në nivelin e tokës. Në brendësi të kishës ndodhen katër pilastra, me prerje thujse katrore. Ndërmjet tyre dhe mureve anësorë, kalojnë harqe gjysmërrethore që, mesa duket, mbanin mbulesën me qemer. Në qendër, duhet të ketë qënë tamburi me kupolën. Në anën lindore, që i takon mjedisit të altarit, është absida gjysmërrethore.

⁴⁴ FRANCIS 2005, f. 99-160; MUSTILLI 1942, f. 681-684; PRENDI 1976, f. 21, 121.

⁴⁵ KORKUTI 1984, f. 5-14.

Në kishë hyhet nga porta e vetme në anën perëndimore, që e lidhte me narteksin. Duke u nisur nga tipologjia dhe nga ndërtimi i mureve të absidës, A.Meksi ka propozuar si periudhë për ndërtimin e saj shek.XIII-XIV⁴⁶. Një ekspeditë arkeologjike e vitit 2015 e drejtuar nga arkeologu S.Muçaj, nga vëzhgimet sipërfaqësore rreth kishës, zbuloi rrënoja të shumta që mund të identifikohen me një manastir të fortifikuar, me një sipërfaqe rreth 0,7 ha. Materiali arkeologjik i gjetur në terren dhe ngjashmëria me objekte të tjera kulti në territorin e vendit tonë, i daton “Rrënojat e Kishës së Shën Gjergjit” në shek. X-XI⁴⁷. Gjithashtu në territorin përreth manastirit janë gjetur rrënoja banesash të antikitetit të vonë si dhe fragmente kolonash antike⁴⁸. Përballë kishës, në anën tjetër të lumit, vitet e fundit janë kryer gërmime arkeologjike shpëtimi në një vendbanim të hapur të periudhës së bronzit të vonë, në vendin e quajtur “Moçalet”⁴⁹.



Fig. 54. Streha shkëmbore ku ndodhet arti shkëmbor i Lepenices. Fig. 55. Pamje e rrënojave të kishës së Shën Gjergjit.

Ura e Bratajt

Ura e Bratajt është një nga monumentet më të rëndësishëm dhe më mbreslënës përgjatë rrjedhës së lumit Shushicë (**Fig. 56**). Është urë guri, e tipit me tre qemerë, me kreun e rrafshët⁵⁰. Këmbët e saj mbështeten në masivin shkëmbor. Ajo është ura më e madhe e periudhës osmane në rrjedhën e lumit Shushicë, rreth 50 m e gjatë, 4 m e gjerë dhe arrin deri në 12 m lartësi⁵¹.

Ura e Frëngut

Ura e Frëngut ndodhet afër fshatit Gjormë dhe ka shërbyer për qarkullimin dhe komunikimin e banorëve të fshatrave, që ndodhen në bregun e majtë të lumit Shushicë⁵². Ajo është urë e tipit me dopjo qemer me harkun në formë lundre dhe me dy dritare shkarkuese. Muratura e saj është e ndërtuar me gur kave të lidhur me llaç gëlqere.

⁴⁶ MEKSI 2004, f. 220-221.

⁴⁷ XHYHERI *ETJ.* 2016, f. 289-292.

⁴⁸ *Po aty.*

⁴⁹ ÇIPA, MESHINI 2016, f. 68-71, tab VIII.

⁵⁰ SHTYLLA 1997, f. 135.

⁵¹ *Po aty.*

⁵² SHTYLLA 1997, f. 58.



Fig. 56. Pamje e “Urës së Bratajt”.

7. REKOMANDIME

Nga parashtrimi i potencialit arkeologjik të zonës kuptohet qartë se lugina e lumit Shushicë ka një pasuri të konsiderueshme arkeologjike dhe historike. Jo më i pakët është edhe potenciali i peisazhit arkeologjiko-historik. Përgjatë vëzhgimit sipërfaqësor të terrenit, sipas projekteve të vëna në dispozicion nga ana e projektuesit, kemi konstatuar disa aspekte të lidhura me trashëgiminë arkeologjiko-historike që duhet të kihen parasysh. Për rrjedhojë, ne do të rekomandonim:

- Miratimin e këtij raporti vëzhgimi nga ana e KKA-së, me përfundimet e arritura.
- Ndërtimi i pendës së pellgut ujmbledhës të HEC Brataj është spostuar në projektin e rishikuar, sipas rekomandimeve të DRKK Vlorë, përtej zonës së mbrojtur të Urës Brataj, monument kulture. Megjithatë pozicioni i ri nuk e cënon hapësirën e monumentit të kulturës, pjesërisht ajo mund të ketë efekt në peisazhin e tij. Për këtë arsye, nëse do të procedohet me lejet përkatëse për ndërtim nga institucionet e ndryshme shtetërore, ne rekomandojmë dy pika: krahu perëndimor i pendës së ujëmbledhësit të spostohet drejt jugut, duke u fshehur tërësisht nga shikimi i vizitorëve që gjenden mbi Urën e Brataj; të garantohet rrjedha normale e ujit drejt urës, veçanërisht përgjatë muajve të verës. Vlerësimi mbi këto aspekte mund të trajtohet nga KKR-ja.
- Në pjesën jugore të traktit 2, siç edhe përmendëm më lart, gjenden gjurmë muresh të një fshati që i takon, ndoshta, mesjetës së vonë. Sipas projektit, afërsisht 50 në perëndim të mureve të këtij fshati, do të kalojë tubacioni i ujit. Këto rrënoja do të humbisnin pjesërisht vlerat e tyre nëse do të cënohej peisazhi arkeologjik rreth tyre. Për këtë arsye, nëse do të procedohet me lejet përkatëse për ndërtim nga institucionet e ndryshme shtetërore, ne do të rekomandonim që në një distancë të mjaftueshme (më së paku 500 m), kanali në këtë hapësirë të realizohet në formë tuneli. Nëse legjislacioni në fuqi e lejon, mund të bashkëpunohet me investitorin për pastrimin e mureve nga bimësia dhe ruajtja e zonës në gjendje vizitueshmërie.

- Në pjesën qendrore të traktit 2, linja e parashikuar e kanalit të derivacionit kalonte afërsisht 500 në perëndim të rrënojave të kishës dhe manastirit të Shën Gjorit. Në aspektin e cënimit të monumentit nuk duket se përbën problem. Në aksin e shtrirjes së linjës nuk u identifikuan gjetje sipërfaqësore (në pjesën ku territori ishte me shikueshmëri të pranueshme terreni). Në aspektin e ruajtjes së peisazhit, nëse do të procedohet me lejet përkatëse për ndërtim nga institucionet e ndryshme shtetërore, rekomandojmë që në një gjatësi të konsiderueshme pranë këtij monumenti kanali i derivacionit të realizohet nëntokë dhe të jetë i mbuluar. Nëse legjislacioni në fuqi e lejon, mund të bashkëpunohet me investitorin për pastrimin e mureve nga bimësia dhe ruajtja e zonës në gjendje vizitueshmërie.
- Në pjesën veriore të traktit 2, siç edhe e përmendëm më lart, u identifikua prania e varreve që i takojnë periudhës qytetare ilire. Gërmimet arkeologjike kanë treguar se janë varre me struktura, me blloqe gurësh drejtkëndorë. Projekti i vendosjes së kanalit të derivacionit parashikon kalimin pikërisht në këtë hapësirë, mbi zonën e varrezës. Për këtë arsye, nëse do të procedohet me lejet përkatëse për ndërtim nga institucionet e ndryshme shtetërore dhe projektuesi kërkon të ndjekë të njëjtën linjë shtrirjeje, punimet duhet të paraprihen nga gërmime arkeologjike. Në të kundërt, projekti duhet të devijohet dhe të krijohet një harkim i gjerë drejt lindjes dhe tubacioni të vendoset pranë fundit të kodrave. Arsyeja e një sugjerimi të tillë lidhet me faktin se në këtë sipërfaqe nuk shikohen gjurmë të pranisë së varreve, për aq sa lejon vëzhgueshmëria e terrenit. Vendosja e kanalit duhet të jetë i maskuar, në mënyrë që të mos kompromentojë peisazhin e zonës. Në bazë të legjislacionit në fuqi, mund të bashkëpunohet me investitorin për pastrimi e zonës nga bimësia dhe ruajtja e saj në gjendje të vizitueshme.
- Në pjesën tjetër të territorit, për aq sa lejonte shikueshmëria e terrenit dhe për aq sa njihen monumentet apo vendbanimet arkeologjike në literaturën e botuar, nuk duket se ka cënim të trashëgimisë. Megjithatë, duke pasur parasysh potencialin e konsiderueshëm të të gjithë pellgut të lumit Shushicë dhe gjetjen e herëpashërëshme të siteve arkeologjike të panjohura më parë, nënvizojmë domosdoshmërinë e realizimit të monitorimit të vazhdueshëm të të gjitha punimeve të cilat prekin nëntokën, nëse do të procedohet me lejet përkatëse për ndërtim nga institucionet e ndryshme shtetërore. Në rast të verifikimit të pranisë së siteve arkeologjike, duhet të ndërpritet puna dhe gjetjet e reja të paraqiten para KKA-së për vendimmarrje të mëtejshme.
- Për punime të tjera, të cilat nuk prekin nëntokën dhe përgjatë të cilave nuk paraqitet nevoja për monitorim punimesh, investitori dhe realizuesi i punimeve, duhet të kenë detyrimin për të njoftuar institucionet e trashëgimisë kulturore (DRKK Vlorë, ASHA), në rast të gjetejve të rastësishme si dhe të ndalojnë punimet deri në vendimmarrjet përkatëse.

8. BIBLIOGRAFIA

ANAMALI 1972

S.Anamali, “Amantia”, *Iliria* 2, 1972, f. 61-150.

BERETI 1995

V.Bereti, “Gjetje nga varrezat antike në territoret e Amantëve”, *Iliria* 1-2, 1995, f. 199-223.

- BERETI ETJ. 2011 V.Bereti, F.Quantin, B.Cabanes, "Histoire et epigraphie dans le region de Vlora (Albanie)", *Revue des Etudes Anciennes*, Nr. 1, Tome 113, 2011, f. 18-23.
- CABANES ETJ. 2008 P.Cabanes, M.Korkuti, A.Baçe, N.Ceka, *Harta Arkeologjike e Shqipërosë*, K&B 2008.
- CEKA 1975 N.Ceka, "Qendrat e fortifikuara të Amantëve", *Monumentet* 10, 1975, f. 21-61.
- ÇIPA, MESHINI 2016 K.Çipa, M.Meshini. "Të dhëna të reja rreth fortifikimeve paraurbane në Shqipërinë Jugperëndimore", *Iliria* XL, 2016, f. 68-74.
- DAUTAJ 1981 B.Dautaj, "Kalaja e Mavrovës dhe identifikimi i saj me qytetin Ilir Olympe", *Iliria* 1, 1981, f. 57-91.
- DAUTAJ 1990 B.Dautaj, "Gërmime arkeologjike të vitit 1990: Olympe", *Iliria*, 2, 1990, f. 266-267.
- KORKUTI 1984 M.Korkuti, "Piktura Shkëmbore e Lepenicës", *Iliria* 1, 1984, f. 5-14.
- KOMANTA 1977-78 D.Komata, "Një vështrim arkeologjik nëpër luginën e Shushicës", *Iliria* 7-8, 1977-1978, f. 363-369.
- KOMATA 1984 D.Komata, "Bazilika Paleokristiane e Mesaplikut", *Iliria* 1, 1984, f. 183-198.
- KOMATA 1989 D.Komata, "Veprate artit provincial Ilir në ekspozitën e Hidelsheimit", *Iliria* XIX/2, 1989, f. 221.
- KRUTJA 1991 P.Krutja, "Lugina e Shushicës", *Gjeografia Fizike e Shqipërisë*, Vëllimi II, ASHERPSSH, QSGJ, Tiranë 1991, f. 343-245.
- MANO, DAUTAJ 1984 A.Mano, B.Dautaj, "Një mbishkrim nga Olympe e Ilirisë", *Iliria*, XIV, 2, 1984, f. 109-118.
- MEKSI 2004 A.Meksi, *Arkitektura e Kishave në Shqipëri (Shekujt VII-XV)*. ShB Uegen, Tiranë 2004, f. 220-221.
- MUSTILLI 1942 D.Mustilli, "Relazione preliminare sugli scavi archeologici in Albania (1937-40)". *RAI, Rendiconti della classe di scienze morali e storiche*, Roma 1942, f. 681-684.
- FRANCIS 2005 K.Francis, "Explorations in Albania, 1930-39: The notebooks of Luigi Cardini, prehistorian with the Italian Archaeological Mission", *BSA Suppl.* 37, 2005, f. 99-160.
- XHYHERI 2013 S.Xhyheri, S.Muçaj, E.Halilaj, L.Sheremetaj, "Kërkime arkeologjike në zonën e Vlorës-2012", *Iliria* XXXVII, 2013, f. 437-458.
- XHYHERI 2016 S.Xhyheri, S.Muçaj, A.Pentkovski, I.Ristani, "Kërkime arkeologjike në krahinën e Vlorës, Mallakastrës, Myzeqesë dhe Korçës", *Candavia* 6, 2016, f. 279-295.
- PRENDI 1955 F.Prendi, "Disa rezultate të ekspeditave arkeologjike në Rrethin e Vlorës gjatë viteve 1953-54", *BSHSH*, 3, 1955, f. 116.
- PRENDI 1976 F.Prendi, "Neoliti dhe Eneoliti në Shqipëri", *Iliria* 4, 1976, f. 21, 121.
- SHTYLLA 1997 V.Shtylla, *Rrugët dhe Urat e Vjetra në Shqipëri*, Toena, Tiranë, 1997.
- HAMMOND 1967 N.G.L.Hammond, *Epirus*, Oxford at the Clarendon Press, Ely House, London 1967.